

STATUTI dhe AKT THEMELIMI I SHOQERISE "HALSA" SHPK

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne fuqi te Republikes se Shqiperise, ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprirtarise private dhe privatizimit". ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare" dhe ne ligjin Nr.9723 date 03.05.2007 "Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare", me vullnetin tim te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt- themelimi dhe statuti te shoqerise

KREU I THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

Neni I: Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 06.02.2024 ne, themeluesit,

- a) **Florian Marku**, atësia Lazer, shtetas shqiptar, identifikuar me numër personal identifikimi I20401242G i datëlindjes 01.04.1982, lindur në Lezhe dhe banues në Tirane; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- b) **Gentiana Marku**, atësia Lazer, shtetas shqiptare, identifikuar me numër personal identifikimi I85109048F i datëlindjes 09.01.1988, lindur në qytetin e Lezhe dhe banues në Tirane; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- c) **Tomi Kallanxhi**, atësia Arben, shtetas shqiptar, identifikuar me numër personal identifikimi I80416072M, i datëlindjes 16.04.1988, lindur dhe banues në Tirane; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- d) **Adela Kallanxhi**, atësia Arben, shtetas shqiptar, identifikuar me numër personal identifikimi I96213044W, i datëlindjes 13.12.1989, lindur dhe banues në Tirane; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

Neni 2: Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet te lejuar me ligj ne Republiken e Shqiperise, duke perfshire por pa u kufizuar ne: Blerje dhe shitje me pakice te produkte te ndryshme online, ose marketingu online etj, ne te gjitha fushat e mesiperme por duke mos u limituar ne to;



Neni 3: Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jetë e pacaktuar.

Neni 4: Selia

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Bulevardi Zogu1, Tirane, Shqiperi

KREU II KAPITALI

Neni 5: Kapitali themeltar

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 2 000 000 (dy miljon) Lekë dhe është i ndarë në 100 kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - a) Ortaku themelues Florian Marku, zotëruar i 40(dyzet) kuota me vlerë të përgjithshme 800 000 (teteqind mijë) Lekë, që përben 40 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - b) Ortaku themelues Gentiana Marku, zotëruar i 40(dyzet) kuota me vlerë të përgjithshme 800 000 (teteqind mijë) Lekë, që përben 40 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - c) Ortaku themelues Tomi Kallanxhi, zotëruar i 10 (dhjete) kuota me vlerë të përgjithshme 200 000 (dyqind mijë) Lekë, që përben 10 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - d) Ortaku themelues Adela Kallanxhi, zotëruar i 10 (dhjete) kuota me vlerë të përgjithshme 200 000 (dyqind mijë) Lekë, që përben 10 % të kapitalit themeltar të shoqërisë
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Kapitali te shtohet ose te pakesohet ne perputhje me ligjet Shqiptare.

Neni 6: Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit



Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontribuieve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit. Ne asne rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerisë

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve te kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqerie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet:


- a) kontributit në kapitalin e shoqerisë;
- b) trashëgimisë;
- c) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme ndermjet ortakëve, dhe nuk lejohet shitja dhe blerja pervec brenda themeltareve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE



Neni 8: Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqerisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqerise që miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e per gjithshme e ortakeve eshte per gjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e me poshtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personave e permendor ne shkronjat "c" dhe 'ç" te kesaj pike;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e per gjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se per gjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e per gjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vandin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te



votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e per gjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi te permendor me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, ne te njejtin rend dite.

Neni 11 **Marrja e vendimeve**

Asambleja e per gjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres per ndryshirnin e statutit, zmadhimin ose zvogelirnin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e litimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e per gjithshre vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshje te tjera si:

- a) percaktirni i politikave tregtare te shoqerise;
 - b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
 - c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
 - c;) percaktimin e shperblimeve
 - d) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administrtoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave finaciare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12 **Perjashtimi nga e drejta e votes**

I. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- ç) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13 **Administrimi**

(1) Asambleja e per gjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte riperteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

(2) Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. cdo emerim i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

(3) Personi i meposhtem caktohet si Administratore i pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme.

Te dhenat e identifikimit: Tea Petriti , lindur me 30/07/1997 ne Korce, Tirane, i pajisur me nr personal J75730080A.



Neui 14

Kompetencat e Administratoreve

Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e per gjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) per gatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se per gjithshme per miratim;
- d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- e) raportojne perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te veçante per veprimtarin e shoqerise tregtare;
- ë} kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjitheshrre, ne rastet kur:

sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshmc brenda 3 muajve ne vazhdim.

-shoqeria propozon te shese apo ti disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiar te certifikuara.

Nese asambleja e per gjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e per gjithshme, mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faj te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Perveç sa eshte parashikuar ne dispozitat e per gjilhshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

I. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vernendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjesdis;

b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

- c) te vleresoje me pergjegjesi çeshtjet, per te cilat merret vendim;
- y) te parandaloje dhe menjanoste rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
- d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.

2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjen ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregetare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave I e .2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperblej shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjt "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e meposhtme:

- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c) u shpemdan aktivet shoqerise;
- ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej ti parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per tishlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Pervec padistik per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financier, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KREU IV VITI FINANCIAR- EKSPERTET

Neni 16 **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me I Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 17 **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithevetor dhe ate ne lidhje me kontrolllet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.



Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perbatit reportin me shkrim per nxjerrjen e rezultalit te bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrolllet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

KREU V
PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuari ne themelin e saj;
 - b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
 - c) me hapjen e procedurave te falimentimit
- y) nese nuk ka kryer veprimitari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimitarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723. date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- d) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjre prej tij emrin e likuidatoril dhe emertesen shtese "Shoqli ne likuidim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur një procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesi e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk merrin një vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, do person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja


Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme se Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX Ligjt 9901 date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjt "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.



Neni 21
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatirnin apo interpretirnin e ketij statuti, si dhe per cdo mosnarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.


O R T A K Ë T
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“HALSA” shpk

Florian Marku




(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Gentiana Marku




(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Tomi Kallanxhi



(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Adela Kallanxhi



(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)